

BESA

Një kod nderi

Myslymanët Shqiptar
që Shpëtuan
Hebrenjtë Gjatë
Holokaust-it

Fotografi të
Norman Gershman

Shqipëria

Në vitin 1934, Herman Bernstein, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, shkruan:

"Nuk ka asnjë gjurmë të diskriminimit të hebrenjve në Shqipëri. Në ditët e sotme, Shqipëria është një nga vendet e pakta në Europë, ku paragjykimet fetare dhe urrejtja nuk ekzistojnë, edhe pse shqiptarët vetë janë të ndarë në tre fe të ndryshme!"

Shqipëria, një vend i vogël në juglindje të brigjeve të gadishullit ballkanik, ka qenë atdheu i një popullsie prej 803.000 banorësh, ku vetëm dyqindë prej tyre ishin hebrenj. Në vitin 1933, pasi Hitleri vuri nën kontroll pushtetin, shumë hebrenj gjetën strehë mbrojtjeje në Shqipëri. Nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e vërtetë të tyre. Sidoqoftë, burime të ndryshme dëshmojnë se 600 - 1.800 emigrant hebrenj nga Gjermania, Austria, Serbia, Greqia dhe Jugosllavia kanë ardhur në trojet shqiptare me shpresën për të vazhduar rrugën drejtë Izraelit dhe vendeve të tjera për të shpëtuar.

Pas pushtimit nazist, në vitin 1943, popullsia shqiptare me një akt jashtëzakonisht heroik kundërshton urdhërin e dhënë nga pushtuesit duke mos dorëzuar listat e banorëve hebrenj që jetonin brënda kufijëve të vendit. Për më tepër agjensitë e ndryshme të Shtetit Shqiptar pajisën shumë familje çifute me dokumenta të falsifikuara. Në këtë mënyrë ato i dhanë hebrenjve mundësinë që të përziheshin me pjesën tjetër të popullsisë. Shqiptarët mbrojtën jo vetëm qytetarët hebrenj vendas, por ata gjithashtu strehuan edhe hebrenjtë që mërguan në Shqipëri gjatë periudhës së sundimit italian dhe më pas, me ardhjen e nazistëve, u ballafaquan me rrezikun e deportimit në kampet e përqëndrimit.

Kjo mbështetje kaq e veçantë, që ju ofrua hebrenjve, bazohej tek koncepti i *Besës*. Është ky kod nderi, që sot ende shërben si kodi më i lart etik për shqiptarët. *Besa* mund të

kuptohet si virtyti i mbajtjes së fjalës dhe premtimit të dhënë. Ai që jep *Besën* merr përsipër jo vetëm jetën e mikut të tij, por edhe të familjes së mikut.

Ndihma që ju dha hebrenjve dhe jo-hebrenjve duhet trajtuar si çështje e nderit kombëtar.

Shqiptarët kanë sakrifikuar në mënyrë të veçantë për të ndihmuar. Shpesh herë ata konkurronin me njëri-tjetrin dhe e ndjenin veten të privilegjuar kur kishin mundësi të shpëtonin sa më shumë hebrenj. Prejardhjen këto akte heroike e kanë tek dhimbsuria, dashuria për njerëzit dhe dëshira për të ndihmuar ata që janë në gjendje të vështirë, edhe pse ata nuk kanë të njëjtën origjinë dhe të njëjtin besim fetar si ne.

Shqipëria, një vend evropian me maxhorancë myslymane, arriti të bëjë diçka që për vendet e tjera të Europës ishte e pamundur. Me përjashtim të anëtarëve të vetëm një familjeje, pothuajse të gjithë hebrenjtë që gjëndeshin brenda trojeve shqiptare gjatë pushtimit nazist shpëtuan. Është me të vërtetë prekëse që pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri jetonin më shumë hebrenj se përpara fillimit të saj.

Të Drejtët Ndër Kombe

"Të shpëtosh jetën e një njeriu, do të thotë të shpëtosh një botë të tërë!"

Qëllimi kryesor i marrjes së vendimit për të ndërtuar Yad Vashem ishte krijimi i një përkujtimeje për ruajtjen e kujtimit të gjashtë milionë hebrenjve, viktime të Holokaustit. Sidoqoftë, një kusht suplementar, brenda këtij ligji, kërkon nga Yad Vashem të nderojë "Të Drejtët Ndër Kombe, të cilët rrezikuan jetën e tyre për të ndihmuar hebrenjtë". Yad Vashem është projekti i vetëm i këtij lloji në botë. Ai nderon individet që shpëtuan hebrenjtë gjatë luftës. Prandaj Yad Vashem ndërkohë ka arritur statusin e një koncepti universal dhe një simboli të rëndësishëm.

Prej vitit 1963, një komisioni të drejtuar nga një gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Izraelit ju ngarkua detyra e dhënies së çmimit "Të Drejtët Ndër Kombe". Në veprimtarinë e tij komisioni bazohet në disa kritere të qarta. Ai kontrollon me hollësi të gjitha dokumentat mbi çështjet që shqyrton. Ai konsideron edhe faktet që jepen nga mbijetuesit ose dëshmitarët okularë.

Personat që marrin çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe" nderohen me një medalje të veçantë, e cila mbart emrin e tyre, shoqëruar kjo nga një certifikatë vlerësuese, si edhe privilegji që emri i tyre i shtohet emrave në Murin e Nderit në Kopshtin e të Drejtëve në Yad Vashem, në Jeruzalem. Ceremonia e dekorimit bëhet për shpëtimtarët ose të afërmit e tyre.

Zhvillohen aktivitete prekëse, të cilat mbahen në Izrael dhe në vende të tjera kudo në botë.

"Të Drejtët Ndër Kombe" janë simbol i ruajtjes së vlerave njerëzore - kundër çthurjes absolute morale. Ata vërtetojnë që pavarësisht nga rreziqet e mëdha, që i cënonin, ekzistonin njerëz që ishin në gjendje të rrezikonin edhe jetën e tyre për të repsektuar principin "Duaje fqinjin tënd, si do veten". "Të Drejtët Ndër Kombe" janë karaktere që duhet të merren si shembull. Ata janë burim shprese dhe frymëzimi.

Deri më sot, Yad Vashem ka nderuar dhe dekoruar 21.758 persona me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe", 63 nga këta janë nga Shqipëria.

Sjellja e "Të Drejtëve Ndër Kombe" ishte e vetmja rreze drite gjatë periudhës aq të zymtë të Holokaustit. Këto gra, këta burra dhe fëmijë tregojnë se atëherë ishte, ashtu si edhe sot është, e mundur që të veprosh me guxim, ndershmëri e zemërgjerësi edhe në kushtet më të vështira.

Destan dhe Lime Balla

"Të gjithë banorët e fshatit tonë ishin myslymanë. Ne strehonim fëmijët e Zotit, sepse i kishim dhënë *Besën*."

Unë kam lindur në vitin 1910. Në vitin 1943, në kohën e Ramazanit, në fshatin tonë, Shëngjergj, erdhën dhjetë persona nga Tirana. Të gjithë ishin nën përndjekjen e gjermanëve. Në fillim, unë nuk e dija që ishin hebrenj. Ne i shpërndamë ata midis banorëve të fshatit. Në shtëpinë tonë qëndruan tre vëllezër me mbiemrin Lazar-i. Ne ishim të varfër dhe nuk kishim as vend për tu ulur, por nuk i lejuam kurrë ata të na paguajnë për ushqimin apo strehimin. Unë shkoja në pyll për të prerë dru e për të mbushur ujë. Në kopësht ne kishim mbledhur perime, pra kishim mjaftë për të ngrënë. Çifutët qëndraun pesëmbëdhjetë muaj në fshatin tonë. Ne i veshëm si veten, si bujq. Të gjithë policët e fshatit e dinin që banorët strehonin hebrenj. Më kujtohet mirë që hebrenjtë flisnin shumë gjuhë të ndryshme.

Në Dhjetor të vitit 1944, hebrenjtë u nisën për në Prishtinë, ku një nip i yni, ish-partizan, i ndihmoi. Pas kësaj ne humbëm çdo kontakt me vëllezërit Lazar. Deri në vitin 1990, pra dyzetë e pesë vjet më vonë, kur Sollomon dhe Mordehaj Lazar-i na kontaktuan nga Izraeli.

Historia si u tregua nga Lime Balla.

Më 4 tetor të vitit 1992, Yad Vashem nderoi Destan Ballën dhe gruan e tij, Lime Balla, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Lime Balla

Mefail Biçaku dhe djali i tij Niazi Biçaku

"Babai im, i cili ende jeton, është myslyman laik. Ai thotë: "Beso vetëm te Zoti"."

Kur kapituloi Italia, në vitin 1943, gjermanët marshuan gjithashtu edhe në Shqipëri. Babai im në atë kohë ishte ende dymbëdhjetë vjeç. Babai i tij, im gjysh, ishte pronar i një dyqani në Tiranë. Babai dhe gjyshi ndihmuan shtatëmbëdhjetë hebrenj të trembur të largoheshin nga Tirana. Ata udhëtuan dymbëdhjetë orë me kuaj për në fshatin e Qarrishtës. Babai ishte këmbëzbathur. Hebrenjtë ishin fshehur në një barakë në kodrat pranë fshatit. Më vonë, këtij grupi ju bashkuan edhe hebrenj të tjerë. Shumë nga ata ishin doktorë, dentistë dhe me shumë profesione të tjera. Natyrisht, me ata ishin edhe gratë dhe fëmijët e tyre. Tim gjyshi të gjithë i drejtoheshin me "Kumbar". Ai nisej rregullisht nga Tirana, i ngarkuar me ushqime dhe sende të tjera të nevojshme. Ndërkohë babai ruante barakën me pushkë. Kështu ata strehuan hebrenjtë më shumë se një vit. Pas disa kohësh, banorët e vendit filluan të kishin frikë se gjermanët do të zbulonin hebrenjtë e fshehur nëpër kodra. Për këtë arsye, ata kërkuan që të fshehurit të largoheshin prej aty. Gjyshi dhe babai vendosën të iknin nga fshati për të jetuar bashkë me hebrenjtë nëpër male. Në vjeshtë të vitit 1944, im gjysh dhe im atë i përcollën hebrenjtë deri në kufi dhe më pas ata vazhduan rrugën e tyre drejt Jugosllavisë.

Në vitet 1960, hebrenjtë u nisën nga Jugosllavia për në vende të ndryshme, si Argjentina, Italia dhe Izraeli. Ne humbëm çdo kontakt me njëri-tjetrin. Pas luftës, gjyshi im u dënua nga regjimi komunist me tre vjet burg. Më kujtohet shumë mirë që ai ishte myslyman shumë i dedikuar. Të themi që, ai nuk i bënte dëm as mizës!

Historia si u tregua nga Elida Biçaku (mbesa e Mefail Biçakut dhe vajza e Niazi Biçakut).

Më 5 maj të vitit 1996, Yad Vashem nderoi Mefail Niazi Biçakun dhe të birin e tij, Niazi Biçakun, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Elida Biçaku me fotografinë e babait të saj, Niazi Biçaku, dhe të gjyshit të saj, Mefail Biçaku

Shaqir dhe Qamile Boriçi; vajza e tyre Bahrije Boriçi

"Përse e strehuam ne familjen hebree? Natyrisht, që do e strehonim, ne ishim një familje!"

Ishte viti 1943. Në atë kohë unë isha shtatëmbëdhjetë vjeçe. Babai im na solli në shtëpi familjen çifute të Isak dhe Bela Bivas, bashkë me vajzën e tyre katërmëdhjetë vjeçe, Rashel. Përpara pushtimit nazist, Isaku blinte në dyqanin e babait tim simite dhe prodhime të tjera të furrës. Ata ishin shokë. Kur u pushtua Shqipëria babai na tha që, familja Isak-ut do të jetonte bashkë me ne si pjesëtarë të familjes sonë. Askush nuk duhet ta dinte që ata ishin hebrenj, por gjithëkujt duhet t'i thonim që ishin të afërmit tanë nga një rreth tjetër. Babai im organizoi pasaporta me emra myslymanësh shqiptarë. Nazistët e kishin paralajmëruar komunitetin shkodran se çdokush që strehonte hebrenjtë, do të dënohej me vdekje. Babai im ishte Kryetar i Bashkisë së Rrethit tonë. Kur nazistët e pytën, ku ishin fshehur çifutët, babai ju përgjigj: "Nuk kam dëgjuar të ketë çifutë në Shkodër". Unë dhe Rashel ishim shoqe të ngushta. Unë i mësova asaj gjuhën Shqipe. Madje, ne të dyja shkonim bashkë edhe në shkollën fetare.

Pikërisht në këtë dhomë, familja Bivas ka jetuar në atë kohë dy vjet. Asgjë nuk ka ndryshuar 60 vitet e fundit. Edhe mobiliet janë të njëjtat që kanë qenë në atë kohë. Përpara kësaj dritareje qëndronin barakat e gjermanëve. Kur gjermanët bënë kontrollë, familja hebree futej në bodrum. Rashel ishte shoqja ime më e mirë. Tani ajo jeton në Izrael.

Historia si u tregua nga Bahrije Boriçi.

Më 8 shtator të vitit 1993, Yad Vashem nderoi Shaqir Boriçin, të shoqen e tij, Qamilen, dhe të bijen e tyre, Bahrije Boriçin, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Bahrije Boriçi

Hysref dhe Emine Frashëri; i biri, Mehmet Frashëri

"Ne e jetonim Kuranin që na mësonte, të kujdesesh edhe për të tjerët. Fqinjët tanë nuk dinin asgjë!"

Babai im ishte shkencëtar. Ai ishte pronar shtypshkronje dhe ishte i njohur në mbarë Shqipërinë. Stërgjyshi ka qenë pjesëtar i shtetit përpara ardhjes në fuqi të Mbretit Zog. Familja jonë gëzon shumë respekt. Ajo ka traditë shumëvjeçare në fushën e edukimit. Gjatë gjithë viteve të regjimit nazist, ne asnjëherë nuk kemi patur frikë të shpëtonim jetën e njerëzve të gjendur në vështirësi. Në vitin 1943, ne strehohim Sabetaj Meshon Gershon-in, gruan e tij Miriam Berah-në, si edhe vajzat e tyre Hanën dhe Stelën. Ata u nisën për në Jugosllavi në fund të vitit 1944. Ne strehuam edhe Jakov (Jasha) Altarac-in në shtëpinë e dytë, e cila gjendej në Kazëm. Ai vinte nga Polonia dhe, në vitin 1943, ishte arratisur nga kampi i italianëve në Burrel. Ne strehuam edhe Jozef Lazar Gertler-in nga Gjermania, i cili gjithashtu ishte internuar në kampin italian në Burrel.

Në vitin 1956, Josef Gertler-i i shkruajti babait tim një letër shumë dashamirëse nga Londra. Në vitin 1990, unë u lidha me Hanën dhe Stelën, të cilat jetonin të dyja në Brazil. Ndërsa, Jakov Altarac jetonte në Izrael. Komunistët e arrestuan babain dhe e dënuan me burg. Më vonë, në vitin 1973, e pushkatuan. Krimi i vetëm i tij ishte që ai ishte njeri intelektual!

Unë vazhdoj të jetoj në Tiranë dhe ngaqë gjithmonë kam bërë sport, gëzoj dhe sot shëndet të mirë.

Historia si u tregua nga Mehmet Frashëri.

Më 3 gusht të vitit 2000, Yad Vashem, nderoi Hysref Frashërin me të shoqen e tij, Emine Frashërin, si edhe të birin e tyre, Mehmet Frashërin, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Fotografia: Mehmet Frashëri

Hasan Hoti, fëmijët e tij, Çele dhe Vehbi, si dhe motra e tij, Fife Hoti

"Të gjithë pjestarët e familjes sonë janë myslymanë të dedikuar."

Gjatë pushtimit nazist, në vitin 1944, kjo shtëpi, në të cilën unë vazhdoj të jetoj, ishte pjesë e një ndërtese më të madhe. Rreth nesh gjendeshin: një kabanon i oficerëve gjermanë, një barakë plot me ushtarë gjermanë, një vend me mbeturina municionesh dhe një ndërtesë për italianët e burgosur gjatë luftës. Të jetoje i rrethuar nga gjermanët ishte e tmerrshme. Unë isha shtatë vjeç. Ne, në shtëpinë tonë, kishim strehuar një vajzë hebreë. Ajo ishte tetëmbëdhjetë vjeçe dhe quhej Rashela Bachar. Dy nga motrat e Rashel-ës ishin fshehur në shtëpitë e tjera të familjes sonë, gjithashtu në Shkodër, ndërkohë që prindërit dhe një motër tjetër ishin strehuar në fshatin Krbë. E gjithë familja ishte arratisur nga burgun nazist i Prishtinës. Nazistët kishin marrë vajzat në pyetje të ndara nga prindërit. Ata i kishin kërcënuar që do t'i vrisnin pa përjashtim, për t'i detyruar t'u tregonin vendin, ku kishin fshehur floriinjët.

Në kohën që Rashela jetonte tek ne, ajo vishej si myslymane. Prindërit e mi e konsideronin si vajzën e tyre dhe ne si motrën tonë. Një ditë, Rashela pa një nga nazistët që e kishte parë edhe në burgun e Prishtinës. Ajo filloi të qante e frikësuar mos atij do t'i kujtohej.

Kur mbaroi lufta, në vitin 1945, Rashela bashkë me prindërit dhe motrat e saj u nisën për në Izrael. Më pas, "Perdja e Hekurt" e ndau Shqipërinë nga bota, gjithashtu dhe ne, për pesëdhjetë vjetë, nuk komunikuam dot më me njëri-tjetrin. Në vitin 1995, me ndihmën e Drita Veselit, e cila mban gjithashtu çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe", ne mund të kontaktonim përsëri Rashel-ën. Në vitin 1998, unë u nisa për në Izrael për të takuar Rashel-ën, e cila tani njihet si "Rachel". Atje unë takova gjithashtu edhe dy djemtë dhe nipin e saj.

Historia si u tregua nga Vehbi Hoti.

Më 22 qershor të vitit 1994, Yad Vashem nderoi Hasan Hotin, motrën e tij, Fife Hotin dhe fëmijët e tij, Çele dhe Vehbi Hotin, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Vehbi Hoti (në të djathtë) me vëllain e tij, Bahri Hoti

Nuro Hoxha

"Si myslymanë të dedikuar, ne i ofruam edhe hebrenjve ndihmën dhe ngrohtësinë tonë. Përse? - Për *Besën*, shoqërinë dhe Kuranin e shenjtë! Kjo është fotografia a babait tim, i cili gjithmonë ka një vend të veçantë në zemrën time!"

Unë jam djali i madh i Nuro Hoxhës. Ai njihej si mësues dhe besimtar i fesë myslymane në komunitetin e Vlorës. Më kujtohen mirë ato ditë të tmerrshme, kur nazistët erdhën nga Greqia dhe pushtuan Vlorën. Hebrenjtë menjëherë u munduan të fshiheshin. Unë atëherë isha dhjetë vjeç. Çifutët e Vlorës dhe të Elbasanit jetonin në Shqipëri që nga viti 1940 dhe shumë prej tyre u arratisën për në Janinë.

Babai im strehonte katër familje çifute. Ata ishin të gjithë shokë të tij. Më kujtohen mirë fjalët e babait, kur bashkë me ta erdhi në shtëpi dhe tha: "Tani ne jemi një familje. Prej ditës së sotme, juve nuk do t'ju ndodhi më asgjë e keqe. Djemtë e mi dhe unë do t'ju mbrojmë nga çdo kërcënim me jetën tonë".

Ne i strehuam familjet në bodrume nëntokësore. Bodrumet shtriheshin poshtë shtëpisë sonë të madhe. Njëkohësisht, aty gjendeshin tre gjenerata të familjeve të Ilia Sollomon-it dhe Mojsi Negrin-it, gjithësej dymbëdhjetë persona. Kishte edhe të tjerë, emrat e të cilëve tani nuk më kujtohen. Bodrumet ishin të lidhur me njëri-tjetrin dhe kishin shumë rrugëdalje. Detyra ime ishte t'u sillja ushqimet familjeve që ishin strehuar aty, si dhe të blija artikujt e nevojshëm për ta. Të gjithë banorët e Vlorës ishin antifashistë dhe e dinin të gjithë, që shumë familje strehonin hebrenj.

Historia si u tregua nga Sazan Hoxha (i biri i Nuro Hoxhës).

Më 21 korrik të vitit 1992, Yad Vashem nderoi Nuro Hoxhën, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Fotografia tregon Nuro Hoxhën me një fotografi të babait të tij.

Besim dhe Aishe Kadiu

"Babai im tha që gjermanët do të duhej të vrisnin familjen e tij përpara se të vrisnin mysafirët hebrenj!"

Ne jetonim në qytetin e Kavajës. Në vitin 1940, për një kohë të shkurtër familja jonë fshehu dy hebrenj grekë nga fashistët italianë. Emrat e tyre ishin Jakov dhe Sandra Batini. Ata ishin motër e vëlla dhe vinin nga Tirana. Babain e tyre e kishin internuar itaianët në një kamp përqëndrimi. Në vitin 1944, Jakovi dhe Sandra përsëri na kërkuan t'i strehonim, sepse ishin të frikësuar nga nazistët. Prindërit e tyre u strehuan nga një familje tjetër. Sandra, Jakovi dhe unë ishim shokë të ngushtë. Ne flinim sëbashku në të njëjtën dhomë gjumi. Më kujtohet që te dritarja prapa dhomës sonë çpuam një vrimë që, në rast se gjermanët do të kuptonin që ne kishim fshehur hebrenj, Sandra dhe Jakovi të shpëtonin pa u kapur. Ne gjithmonë kontrollonim, nëse kishte patrulla gjermanësh. Kur gjermanët filluan të kontrollonin të gjitha shtëpitë për të gjetur hebrenjtë e fshehur, babai im u nis bashkë me Jakovin e Sandrën drejt një fshati të largët. Më pas, deri sa u çlirua vendi, ne kujdeseshim që atyre mos t'i mungonte asgjë. Festa e çlirimit në Kavajë u bë shumë e madhe. Më kujtohet telegrami që morrëm nga Jakovi dhe Sandra dhe gëzimi i madh për ditën e çlirimit. Shumë shpejt ata u nisën për në Tiranë dhe më vonë vazhduan udhëtimin drejt Izraelit.

Unë kam shumë letra dhe fotografi të mrekullueshme nga Izraeli. Në vitin 1992, u ftova që të marrë çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe" në emër të të gjithë familjes sonë. Për më shumë, për një periudhë kohe unë kam qenë edhe drejtuese e Shoqatës së Shoqërisë Shqipëtare-Izraelite. Kohët e luftës ishin të frikshme, por shoqëria e mposhti frikën!

Historia si u tregua nga Merushe Kadiu (e bija e Besim dhe Aishe Kadiut).

Më 21 korrik të vitit 1992, Yad Vashem nderoi Besim Kadiun dhe të shoqen e tij, Aishe Kadiun, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Merushe Kadiu

Zyrha Kasapi dhe i biri, Hamdi Kasapi

"Hamdiu dhe Zyrhaja ishin që të dy besimtarë myslymanë. Ata besonin që është detyrë morale e çdo njeriu që të ndihmojë të tjerët. Feja ishte pjesë e edukimit tonë familjar. Për ne, as që nuk mendohej të denonconim hebrejtë të cilët kishin aq shumë nevojë për përkrahje, por pesëdhjetë vjet komunizëm na holluan ndjenjat e larta."

Burri im, Hamdi Kasapi, vdiq në vitin 1989. Ai ishte kineast dhe i dalluar si Hero i Punës së Shqipërisë Socialiste. Ai dhe nëna e tij, Zyrhaja, janë nderuar nga Yad Vashem si "Të Drejtët Ndër Kombe". Unë edhe dy djemtë e mi, Naimi dhe Francis, ruajmë akoma kujtimin e ndihmës që Hamdiu dhe Zyrhaja i dhanë familjes çifute të Mose Frances, gruas, dy fëmijëve dhe mamasë së tij. Ata erdhën nga Shkupi i Maqedonisë dhe ne i strehuam në shtëpinë tonë, në Tiranë. Hamdiu e njihte gjuhën Maqedonase. Familja e Mose Frances u strehua nga ne për dy vjetë. Njëherë ata qëndronin tek apartamenti ynë i vogël në Tiranë dhe më pas ne i ndërronim vendin për t'i fshehur në shtëpinë e disa shokëve tanë në fshatin fqinj, Babru. Ishte shumë e vështirë, sepse ne kishim vetëm dy dhoma.

Në vitin 1944, terrori gjerman kishte arritur kulmin e tij. Bëheshin kontrole në çdo shtëpi të Tiranës, por ne i kishim dhënë familjes hebreë emra dhe rroba shqiptare dhe i kishim strehuar në Babru për t'i mbajtur më të sigurt. Një ditë, znj. Frances bashkë me fëmijët e saj erdhën nga shtëpia e Babroit për të na vizituar, por u detyruan të kalonin natën në shtëpinë tonë, sepse kishin frikë nga patrullat gjermane. Atë natë, gjermanët trokitën edhe në derën tonë. Znj. Frances doli nga dera e prapme e shtëpisë, për tu fshehur në shtëpinë fqinje. Ndërsa fëmijët u futën në krevate bashkë me fëmijët e familjes sonë. Gjermanët e goditën Hamdiun deri sa ai mbeti pa ndjenja, më pas ata u larguan. Fëmijët e Mose Frances e panë me sytë e tyre brutalitetin, me të cilin gjermanët keqtrajtuan mbrojtësin e tyre. Ata e mbijetuan luftën dhe u kthyen në Maqedoni.

Në vitin 1948, ata emigruan për në Izrael. Ne humbëm çdo kontakt me ta deri në vitin 1990, kur shqiptari i parë që mori çmimin e "Të Drejtët Ndër Kombe", Refik Veseli, u lidh në Izrael edhe me fëmijët e Mose Frances: Mercelin dhe Esterin. Por kjo ndodhi pasi kishte vdekur i ndjeri Hamid.

Historia si u tregua nga Adile Kasapi (e shoqja e Hamdi Kasapit).

Më 14 shkurt të vitit 1995, Yad Vashem i dha Zyrha Kasapit dhe djalit te saj, Hamdi Kasapi, çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Adile Kasapi me fotografinë e të shoqit, Hamdi Kasapi

Kasem Jakup Kocerri

"Që prej 500 vjetësh, ne jemi familje me fe myslymane. "Ai që shpëton një jetë, shkon në parajsë". Besa e ka prejardhjen nga Kurani. Përshëndes të gjithë hebrenjtë. Uroj që shtëpitë e tyre të jenë të shejnta dhe e pi këtë gotë raki për shëndetin e të gjithë shokëve të mi hebrenj. Jam krenar që Yad Vashem më ka nderuar me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe"!"

Unë kam lindur në vitin 1915. Gjithë jetën time unë kam qenë bari në Vlorë. Unë jetoja bashkë me bagëtitë e familjes nëpër kodra. Në Vlorë kishte shumë familje çifute, të cilët prej shumë kohësh ishin pjesëtarë të komunitetit vlonjat. Më kujtohet që Jakov Solomoni kishte funksionin e rabinit gjatë festave hebree. Ne ishim shokë të ngushtë. Hebrenjtë dhe myslymanët janë kushërinj!

Në fillim të vitit 1944, divizionet gjermane erdhën nga Greqia në fshatin tonë. I tërë fshati ju bashkua frontit kombëtar të partizanëve. "Nëse gjermanët vrisnin një shqiptar, ne vrisnim 100 gjermanë". Gjermanët kërkonin hebrenj që, "si vrasës të Krishtit, t'i digjnin për së gjalli me benzinë". Unë mora Jakov-in dhe familjen e tij dhe ne u nisëm me kuaj drejt kodrava. Gjatë natës, unë i strehova në stallën ku mbaja delet. Një pjesë e familjes ishin ndarë, fshatarët e tjerë i kishin fshehur nëpër pyje. Qentë tanë i ruanin nga çdo person i huaj si dhe nga patrullat gjermane. Njerëzit e tjerë të fshatit tonë, strehuan pjesën tjetër të hebrenjve.

Ne strehuam një pjesë të familjes Solomoni për gjashtë muaj, deri në fund të vitit 1944, kur gjermanët u larguan. Të gjitha familjet hebree të Vlorës mbijetuan, por askush nga ata nuk e dinte që familjarët e tyre kishin mbijetuar, deri në momentin që u takuan me njëri-tjetrin, pasi ishin larguar gjermanët. Gjermanët masakruan shumë nga partizanët e Vlorës, disa nga ata, madje u deportuan në "kampe vdekje". Familjet hebree qëndruan në Vlorë edhe në kohën e komunizmit, deri në vitin 1991. Më pas, disa shkuan për në Greqi. Sidoqoftë, shumica mërgoi drejt Izrael-it. Ne akoma komunikojmë me Jeannette Solomoni-n, të bijën e Jakov-it. Ajo është në Izrael.

Më kujtohet që Jakov-i më tregoi një pemë ku kishte fshehur dhjetë monedha ari, të cilat më ofroi t'i merrja unë. Unë rrefuzova. Unë nuk kam marrë para nga miqtë e mi hebrenj!

Historia si u tregua nga Jakup Kocerri.

Më 31 mars të vitit 1993, Yad Vashem e nderoi Kasem Jakup Kocerrin, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Nga e majta në të djathtë: Barbuqe, Kasem, Jakup Kocerri, Bino, Ana

Sulejman dhe Zenepe Meçe

"Gjyshi im ishte si "Nën Tereza". Ne jemi myslymanë të vërtetë. Na e dha Zoti mundësinë dhe privilegjin për të shpëtuar hebrenjtë. Çdo jetë është e çmueshme dhe dhuratë e Zotit. Gjyshi dhe gjyshja bashkë me xhaxhallarët, i shpëtuan hebrenjtë me vetëdije, duke mos patur aspak frikë."

Gjyshi dhe gjyshja quheshin Sulejman dhe Zenepe Meçe. Pikërisht në këtë shtëpi, familja ime ka strehuar një familje të madhe çifute me emrin Batino, e cila përbëhej nga vëllezër, nuse e fëmijë, dhe ishin gjithësej tetë persona. Familja ime i mbante të fshehur në çati. Ata asnjëherë nuk kanë dalë nga shtëpia. Gjyshi dhe gjyshja nuk i njihnin, por ata ishin miqtë e disa miqëve tanë. Ata i dhanë familjes Batino *Besën*. Asnjëherë nuk kërkuan ndonjë shpërblim.

Shtëpia jonë është afër një fshati pranë Krujës. Rruga për të zbritur është e vështirë, por e sigurt, sepse gjermanët në atë rrugë shumë rrallë na kontrollonin.

Një nga fshatarët, i cili mendohej të ishte informues i gjermanëve, e pyeti gjyshin tim, Sulejmanin, nëse ai mund të vinte për të takuar njerëzit e strehuar. Im gjysh iu përgjigj: "Nëse ti guxon t'i afroresh shtëpisë sime, unë do të vras"! Gjithashtu i tha që, nëse ai do t'u përcillte ndonjë lajm gjermanëve, ose gjyshi vetë, ose ndonjë nga fshatarët e tjerë, do ta vritnin. Për shumë ditë, xhaxhai im, Ismaili, ruante përpara shtëpisë me pushke. Ai do t'i mbronte të strehuarit deri sa të kalonte çdo rrezik.

Në dhjetor të vitit 1944, Batino-t u kthyhen në Tiranë. Për një kohë familjet tona komunikonin shpesh me njëra-tjetrën, derisa u ndaluan nga komunistët. Ne kemi dëgjuar që Jakov-i dhe motra e tij, Sandra, më në fund mundën të emigronin në Izrael në vitin 1994. Xhaxhai im, Ismaili, i shoqëroi. Që nga ajo kohë vazhdojmë të kemi dhe sot kontakt. Familja jonë kishte troje tokash, si edhe një dyqan. Ne kishim ullishte, vreshta dhe bagëti. Çdo gjë na u mor nga komunistët, vetëm shtëpia mbeti. Sot, unë i shërbej komunitetit të Krujës si pjesëtar i Këshillit të Qytetit.

Historia si u tregua nga Hamdi Meçe (i nipi i Sulejman dhe Zenepe Meçes).

Më 21 qershor të vitit 1992, Yad Vashem nderoi Sulejman Meçen dhe të shoqen e tij, Zenepe Meçen, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

I biri i Sulejman dhe Zenepe Meçes, Hamdiu, me të shoqen e tij Zenepe Meçen

Njazi dhe Liza Pilku

"Im atë ka qenë myslymanë i dedikuar. Ai ka bërë planet e ndërtimit të xhamive në Shqipëri."

Gjatë luftës, vëllai im dhe unë ishim djem të rinj. Prindërit tanë strehuan një familje çifute për një vit, duke ndryshuar gjithmonë vendbanim. Ata qëndronin herë në shtëpinë tonë në Durrës, e herë në shtëpinë e plazhit. Ata ishin Familja Gerechter, e cila përbëhej nga babai, nëna dhe vajza - ishin nga Hamburg-u i Gjermanisë. Ata kishin kërkuar azil në Shqipëri pas "Kristallnacht" (Nata e kristaltë). Pasi, ata kishin qenë të internuar nga italianët dhe të arrestuar nga kolaboratorët shqipëtarë, babai im mundi më në fund t'i shpëtonte. Nëna ime ishte gjermane. Nazistët vinin shpesh për vizitë në shtëpinë tonë në plazh.

Për familjen Gerechter, nazistëve ne i thonim që ishin të afërmit tanë nga Gjermania. Sigurisht, që ata ishin shumë të frikësuar. Njëherë, gjermanët i bllokuan të gjitha rrugët e qytetit të Durrësit. Ata filluan të kërkonin hebrenjtë me qen. Mamaja ime doli nga shtëpia dhe filloi të shante Gestapon në gjuhën Gjermane, duke i thënë të mos ktheheshin më në shtëpinë tonë dhe të mos harronin, që ajo ishte gjermane. Gestapo u largua.

Mbas luftës, ne humbëm çdo gjurmë të Gerechter-ve. Komunistët morrën pushtetin dhe ndaluan komunikimin me çdo njeri që ishte jashtë vendit. Babai im u arrestua në vitin 1944. Në vitin 1945, komunistët e ekzekutuan. Shtëpia e plazhit u kufiskua. Mbas rënies së sistemit komunist, ne kemi kontaktuar vajzën e familjes Gerechter, Johanna Neumann, e cila edhe sot jeton në Amerikë. Johanna dëshmoj për mbrojtjen që ne i kishim ofruar familjes së saj gjatë luftës dhe Yad Vashem i dha prindërve të mi çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Historia si u tregua nga Edip Pilku (i biri i Njazi dhe Liza Pilkut).

Më 26 qershor të vitit 1997, Yad Vashem nderoi Njazi Pilkun dhe të shoqen, Liza Pilku, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Fotografia: Edip Pilku me fotografinë e babait të tij, Njazi Pilku

Beqir Qoqja

"Unë gjithmonë kam qenë myslyman i përkushtuar. Gjatë viteve të komunizmit të gjitha institucionet fetare u mbyllën, por jo zemra. Unë nuk bëra asgjë të veçantë. Të gjithë hebrenjtë janë vëllezërit tanë!"

Unë jam nëntëdhjetë vjeç dhe gëzoj shëndet të mirë. Unë jetoj bashkë me tim bir dhe familjen e tij, në të njëjtën shtëpi që jetoja në kohën kur strehoja mikun tim hebre, Avram Eliasaf Gani, gjatë viteve 1943 - 1944. Në fillim, unë e mbaja Avram-in këtu, por kur persekutimi i hebrenjve nga gjermanët u bë edhe më i egër, unë e fsheha atë në shtëpinë e prindërve të mi në një vend të largët të Krujës. Në atë kohë, drejt atij vendi nuk kishte as rrugë makine. Unë shkoja atje çdo javë, deri sa mbaroi lufta. I sillja kështu mikut tim ushqime dhe çdo gjë që i nevojitej.

Gjatë viteve të luftës, përveç familjes sonë, nuk e dinte askush, që ne kishim strehuar një hebre. Mbas lufte, Avram-i u kthye në Tiranë, por ne mbetëm akoma shumë shokë. Unë tërë jetën kam qenë rrobaqepës. Tani unë kam dalë në pension dhe të gjithë më drejtohen me "Babai". Akoma më pëlqen të vishem mirë.

Historia si u tregua nga Beqir Qoqja.

Më 21 qershor të vitit 1992, Yad Vashem nderoi Beqir Qoqen, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Beqir Qoqja

Ali Sheqer Pashkaj

"Babai im shpëtoi jetën e një njeriu dhe vuri në rrezik jo vetëm jetën e tij, por të të gjithë fshatarëve. Përse e bëri këtë? Babai im ishte myslyman i dedikuar. Ai besonte, që kush shpëton jetën e njerëzve shkon në parajsë!"

Shtëpia jonë tradicionale është në Pukë. Babai im kishte një dyqan me artikuj të ndryshëm ushqimor. Ishte i vetmi dyqan i tillë në një zonë prej disa kilometrash. Një ditë, gjermanët po transportonin nëntëmbëdhjetë të burgosur shqiptarë, për t'i detyruar të bënin punë të rëndë. Ndërmjet tyre gjendej edhe një hebre, të cilin do ta pushkatonin. Babai im e fliste shumë mirë gjermanishten. Ai i ftoi nazistët të vinin në dyqanin e tij, ku i ofroi atyre ushqime dhe verë. Ai i mbushi ata me verë deri sa gjermanët u dehën.

Ndërkohë, ai fshehu një letër tek një copë bostani dhe ja dha hebreut të ri. Në letër babai e udhëzoi të burgosurin, si të largohej dhe të fshihej nëpër pyje, në një vend të caktuar. Nazistët u tërbuan, kur panë që hebreu kishte mundur të arratisesh. Sidoqoftë, babai im bëri sikur nuk ishte ne dijeni me këtë ngjarje. Ata e sollën babain në fshat dhe e lidhën në një mur, për ta detyruar që të tregonte, ku ishte fshehur hebreu.

Katër herë ata i vendosën pushkën te koka. Ata u këthyhen dhe thanë që do të digjnin edhe fshatin, nëse babai im nuk tregonte. Por babai qëndroi i durueshëm, dhe më në fund ata ikën. Babai e gjeti djalin në pyll dhe, për dy vjetë, e strehoi atë në shtëpinë tonë, deri sa mbaroi lufta. Emri i tij ishte Yoshua Baruchowic. Në fshatin tonë ishin tridhjetë familje, por askush nuk e dinte, që im atë kishte strehuar një hebre. Yoshua është akoma gjallë. Ai është dentist dhe jeton në Meksikë.

Historia si u tregua nga Enver Alia Sheqeri (i biri i Ali Sheqer Pashkaj).

Më 18 mars të vitit 2002, Yad Vashem e nderoi Ali Sheqer Pashkaj, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Fotografia: Enver Ali Sheqeri me statujën e heroit Kombëtar Shqipëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Eshref Shpuza

"Më duket çudi kur më pyesin, përse babai im ndihmoi një familje çifute. Për të gjithë popullin shqiptar *Besa* është traditë shumë e rëndësishme!"

Prindërit e mi jetonin në qytetin e Durrësit. Në vitin 1944, babai im u miqësua me familjen hebreë të Raphael (Rudi) Abravanel-it. Ata ishin me origjinë nga Jugosllavia. Ai i gjeti familjes së Rudit, e cila përbëhej, nga halla, xhaxhai i tij dhe dy fëmijë, pasaporta të fallsifikuara dhe i shoqërojë ata deri në kufij. Më pas, familja jonë e humbi çdo gjurmë të Abravanel-ve.

Vetëm me ndihmën e një shqiptari tjetër, Refik Veselit, që kishte marrë çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe", në vitin 1990, mundëm të kontaktonim përsëri Rudin dhe familjen e tij. Ata, tashmë, jetojnë në Izrael. Ne vazhdimisht këmbëjmë letra dhe telefonojmë me njëri-tjetrin.

Historia si u tregua nga Ismet Shpuza (i biri i Eshref Shpuzës).

Më 31 mars të vitit 1993, Yad Vashem e nderoi Eshref Shpuzën, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe" për shpëtimin që ai i kishte bërë familjes Abravanel dhe dy pjesëtarëve të familjes të filozofit hebre.

Ismet Shpuza me djemtë e tij

Vëllezërit Hamid dhe Xhemal Veseli

"Prindërit tanë ishin myslymanë të dedikuar dhe besonin, ashtu siç besojmë edhe ne që: "çdo trokitje në derën tënde është bekim nga Zoti". Ne asnjëherë nuk kërkuam ndonjë shpërblim nga miqtë tanë hebrenj. Të gjithë njerëzit janë fëmijët e Zotit. Besa ekziston në çdo zemër shqiptare!"

Vëllai ynë, i cili ka vdekur, Refiku, ishte shqiptari i parë që u nderua me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe" nga Yad Vashem. Tashmë dhe neve na është dhënë ky nder për strehimin e familjes së Jozef Ben Jozef-it dhe familjes Mandil-i. Gjatë pushtimit italian Jozef-i punonte për mua (Hamidi) në dyqanin e rrobave, ndërsa Moshe Mandil-i punonte në studion fotografike të vëllait tim, Refikut. Të dyja familjet kishin ardhur në Shqipëri si emigrantë nga Jugosllavia.

Kur erdhën gjermanët, në vitin 1943, të dyja familjet hebree ne i dërguam në shtëpinë e familjes sonë në Krujë. Xhemali i shoqëroi prindërit ditë e natë, duke ecur 36 orë në këmbë deri sa arritën në shtëpinë e atjeshme. Ne i veshëm si fshatarë. Pas dy ditësh ne sollëm edhe fëmijët në Krujë. Gjatë ditës, të rriturit ne i mbanim të fshehur në një shpellë në malet afër fshatit tonë. Fëmijët luanin me fëmijët e tjerë të fshatit. Gjithë fqinjët tanë e dinin, që ne strehonim familjet hebree. Kishte edhe familje të tjera hebree që ishin fshehur. Një ditë, gjemranët nisën të kontrollonin çdo shtëpi për të gjetur një pushkë, e cila i kishte humbur një ushtari të tyre. Ata nuk mundën ta gjenin pushkën dhe e ekzekutuan ushtarin që e kishte humbur. Ne i strehuam hebrejtë për nëntë muaj deri sa u çlirua Shqipëria. Ne humbëm çdo kontakt me familjen e Ben Jozef-it. Ata u nisën shumë shpejtë drejt Jugosllavisë dhe ne kemi frikë, se gjermanët mund t'i kenë vrarë gjatë tërheqjes së trupave të tyre. Familja Mandil-i gjithashtu u nis drejt shtëpisë së tyre, në Jugosllavi. Vëllai ynë, Refiku, shkoi ti takonte pas lufte, ku dhe studjoi fotografi bashkë me Moshen.

Menjëherë, më pas, familja Mandil-i emigroi për në Izrael.

Ne shqiptarët i kemi hapur dyert tona katër herë. Për herë të parë ia hapëm grekëve, gjatë krizës së Luftës së Parë Botërore, më vonë ushtarëve italian, të cilët mbetën në vendin tonë, pasi ju dorëzuan Aleatëve, pastaj i hapëm dyert tona për hebrejtë gjatë pushtimit nga gjermanët dhe së fundi për refugjatët shqiptarë që erdhën nga Kosova drejt një shpëtimi nga serbët. Të vetmit që shprehën mirënjohje ishin hebrejtë!

Historia si e treguan Hamid Veseli dhe Xhemal Veseli.

Më 23 maj të vitit 2004, Yad Vashem nderoi vëllezërit Hamid dhe Xhemal Veseli, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Nga e majta në të djathtë: Hamid Veseli, Xhemal Veseli

Vesel dhe Fatime Veseli; i biri i tyre Refik Veseli

"Shtëpia jonë është mbi të gjitha shtëpia e Zotit, pastaj e mysafirëve dhe pastaj e familjes sonë. Kurani na mëson që të gjithë njerëzit, qofshin hebrenj, myslymanë apo të krishterë, kanë vetëm një Zot!"

Im shoq ishte fotograf. Ai e mësoi zanatin e fotografit nga një fotograf hebre, i cili quhej Moshe Mandil. Italianët e deportuan familjen Mandil-i nga Prishtina e Kosovës për në Tiranë. Kur u pushtua Shqipëria nga gjermanët im shoq, me lejen e prindërve të tij, strehoi të katërt pjesëtarët e familjes Mandil-i, si edhe tre pjesëtarët e familjes Ben Jozef-i në malet e një fshati të Krujës. Të shtatë hebrenjtë qëndruan të strehuar atje, deri sa u çlirua vendi. Refik Veseli bashkë me prindërit e tij, Fatime dhe Vesel Veseli, janë shqiptarët e parë, të cilëve ju dha çmimi "Të Drejtët Ndër Kombe" nga Yad Vashem.

Kur e pyetën tim shoq se si ishte e mundur që kaq shumë shqiptarë kishin ndihmuar të strehonin dhe të mbronin hebrenjtë, ai shpjegoi: "Në Shqipëri nuk ka asnjë të huaj. Çdo njeri është mysafir. Janë rregullat e mirësjelljes shqiptare, që nga secili prej nesh kërkojnë të mirëpresim mysafirët në shtëpinë dhe në vendin tonë". Kur e pyetën tim shoq, nëse ishte e mundur që ndonjë shqiptar t'i raportonte gjermanëve për hebrenjtë e fshehur, ai u përgjigj, që edhe nëse diçka e tillë mund të kishte qenë e mundëshme, "ai shqiptarë që do të bënte këtë, do të turpëronte të tërë fshatin dhe familjen e tij. Të paktën shtëpia e tij do të shkatërrohej dhe banorët do ta largonin nga fshati i tyre". Por kjo ishte vetëm një pyetje teorike, sepse "asnjë shqiptar nuk na turpëroi". Studion fotografike "VESELI" tashti e drejton djali im në Tiranë.

Historia si u tregua nga Drita Veseli (e shoqja e Refik Veselit).

Më 23 dhjetor të vitit 1987, Yad Vashem nderoi Vesel Veselin dhe të shoqen e tij, Fatime Veselin, si edhe djalin e tyre, Refik Veselin, me çmimin "Të Drejtët Ndër Kombe".

Drita Veseli me fotografinë e burrit të saj, Refik Veseli

Besim dhe Higmat Zyma

"Përse i fshehëm hebrenjtë? Ne thjeshtë e bëmë këtë gjë. Nuk kishim asnjë dyshim. Në të vërtetë, mysafiri ynë hebre ishte shokë i një mikut tonë. Ne jemi myslymanë, por myslymanë liberal."

Ishte viti 1944. Një miku ynë, na u lut të strehonim një burrë të moshuar hebre nga Polonia. Ai quhej Lew Dzienciolski. E përse mos ta mbanim? Im shoq, Besimi, ishte mjek i zoti. Ai punonte në spital dhe ne kishim gjithashtu dhe një klinikë në bodrum. Më kujtohet që zoti Dzienciolski shikonte vetëm nga një sy. Besimi i fashoi të gjithë fytyrën, duke e fshehur kështu në klinikën tonë. Atëherë gjermanët nuk na ngacmuan më.

Unë jetoj sot në të njëjtin apartament, në të cilin kam jetuar me tim shoq. Unë jam piktore dhe këto që shikoni janë pikturat e mia, njëra me Besimin, që tani ka vdekur dhe tjetra me tulipanë.

Historia si u tregua nga Higmat Zyma.

Më 25 korrik të vitit 1999, Yad Vashem nderoi Besim Zymën dhe të shoqen tij, Higmat Zymën, me çmimin Të Drejtët Ndër Kombe.

Higmat Zyma me një portret të burrit të saj, Besim Zyma

Historitë personale ju treguan fotografit Norman Gershman.